



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.650/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Subjektit Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD) - Gazmend Islami, me seli në Komunën e Podujevës, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjete sociale, për Zgjedhjet Lokale 2021 të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa Anr.650/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD) - Gazmend Islami- me seli në Podujevë, Thyerja e heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale. Ndërsa subjektit politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD) - Gazmend Islami, me seli në Podujevë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 (treqind euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021.

**II. DETYROHET** Subjekti Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD)-Gazmend Islami që gjobën e shqiptuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.650/2021, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Subjektit Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD)-Gazmend Islami me të cilën pretendohet se

Gazmend Islami, kandidat për asambleist në Komunën e Podujevës, ditën e zgjedhjeve më 17 tetor, përmes rrjetit social "Facebook", ka sponsorizuar një postim me anë të cilit ka kërkuar nga qytetarët që të votohet. Në vazhdim të ankesës theksohet se ky postim i sponsorizuar është shfaqur përdoruesve të atij aplikacioni ditën e zgjedhjeve dhe në këtë mënyrë konsiderohet se ka ndikuar tek të njëjtit për mënyrën e votimit dhe me këtë veprim kandidati në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore.

Sipas pretenduesit të ankesë veprimi i tillë bënë pjesë në veprimet e ndaluara gjatë ditës së zgjedhjeve sipas Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve të tyre Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka bashkangjitur si dëshmi një fotografi të printuar të shkeljes së supozuar sipas ankesës.

PZAP, më datë 18.10.2021 i ka paraqitur subjektit politik Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD)-Gazmend Islami, kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.650/2021 me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 09:00.

Subjekti Politik OBKD, me datë 19.10.2021 në PZAP, ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën pretendimet e ankuesit janë verifikuar nga ana e tyre dhe se e njëjta është pranuar nga administratorja e faqës së tyre në rrjetin social-Facebook, Arjeta Fetahu, njëherit përfaqësuese e autorizuar për OBKD dhe thekson se shkak i atij gabimi ka qenë presioni i fushatës dhe përgjegjësit e shumta që ka pasur dhe në momentin kur është bërë sponsorimi për postimin në fjalë është bërë një lëshim në përcaktimin kohor.

Më tej në përgjigje në ankesë OBKD, ka kërkuar mirëkuptimin e PZAP-it dhe merr përgjegjësinë për këtë lëshim dhe thekson se nuk e ka bërë për qëllim të dëmtimit të ndonjë subjekti politik apo prishjes së rregullit të zgjedhjeve pasi që edhe si subjekt njihen për zbatim të mirëfilltë të çdo rregulli që përcaktohet nga KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se subjekti politik Subjekti Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD)- përkatësisht Gazmend Islami, kandidat për kryetar në Komunën e Podujevës, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social "Facebook" ka

bërë fushatë zgjedhore ashtu që përmes rrjetit social "Facebook" ka bërë një postim ku shihet edhe fotoja e tij me numër të subjektit politik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton "*Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve te tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*".

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse postimi i kandidatit për kryetar në Komunën e Podujevës, Gazmend Islami, ishte i publikuar më datë 17.10.2021 dhe nga pranimi i palës në përgjigjen e ofruar nga përfaqësuesja e subjektit të tij politik.

Në raport me pretendimet e përfaqësueses së Subjektit Politik, Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD), se është bërë gabim nga presioni i fushatës dhe është bërë gabim në përcaktimin kohor, duhet të hudhet si e pabazuar ngase postimi ka qenë aktiv ende në ditën e zgjedhjeve, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrës të Votimit dhe se ka qenë ende aktiv postimi është vërtetuar pas verifikimeve të bëra nga PZAP, andaj si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore prandaj edhe se ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova është e bazuar.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Organizata Balli Kombëtar Demokrat (OBKD), ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje që ti njoftoj kandidatët e saj lidhur me respektimin e legjislacionit në fuqi me qëllim të evitimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore, e të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në

të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa**  
Anr.650/2021 më datë 20.10.2021

**Kryesues i Panelit**



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***